



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 709/ prot. 25

Elbasan, me 20.03.2025

VENDIM

Nr. 31 datë 20.03.2025

Për

Hapjen e programit të Ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Gjuhë angleze" edhe në gjuhën angleze, në Fakultetin e Shkencave Humane në Universitetin Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për vitin akademik 2025-2026

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2, shkronja b, neni 35, pika 1, neni 38 pika 1, germa "dh", neni 49, pika 1, në Udhëzimin e MASR nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen dhe bashkimin e IAL", Kreu IV, germa A, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr.10, datë 30.03.2020 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, në Vendimin nr. 14, datë 10.03.2025 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në "Gjuhë angleze"/ "English language" të Fakultetit të Shkencave Humane të UE, që të zhvillohet edhe në gjuhën angleze, sipas dokumentacionit bashkëngjitur për vitin akademik 2025-2026.
2. Tarifa e shkollimit për këtë program do të jetë në vlerë 2500 Euro.
3. Burimi i financimit për këtë program studimi të jetë tarifa e shkollimit për program dhe pa efekte financiare shtesë nga buxheti i UE-së".
4. Ky vendim i përcillet Rektorit, Administratorit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe Fakultetit të Shkencave Humane të UE-së
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dr. Ardian DËRMISHI

